**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO**

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

Adresa:rr.”Adem Jashari” pn, www.rks-gov.net/gjilan, tel.0280 320 781, 0280 320 782, 0280 321 482, 0280 321 486

Në bazë të nenit 14., 16, 17, 20, 22 dhe 24.1 dhe 2. të Ligjit për Planifikim Hapsinor, nr. 2003/14, nenit 38.1.2 dhe Ligjit për Ndryshimet e Ligjit për Planifikim Hapësinor.nr. 03/L-106, Udhëzimit Administrativ për zbatimin e Ligjit për planifikimin hapësinor mbi elementet e themelore të Planit Rregullues Urban, nr. rend. 41, nr. prot.02/05, nenit 38.1.2. të Statutit të Komunës së Gjilanit,e në vështrim të pikës V. të Vendimit mbi miratimin e Planit Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjilanit, nr. 01-17735 të dt. 30.10/2008, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë: 06.04.2012, miraton këtë:

# V E N D I M

## Për miartimin e Propozim Zgjidhjes Urbanistike për ndërtimin e objektit të Agjencionit të Intelegjencës së Kosovës në Gjilan

1.

Me këtë vendim miratohet Propozimi Zgjidhja Urbanistike për ndërtimin e objektit Administrativ të Agjencësë së Intelegjencës së Kosovës në Gjilan në pjesën e parcelës kadastrale nr. 2145-2, në sipërfaqe prej 0.30.00 ha (tridhjet ari), nga sipërfaqja e tërësishme prej 1.68.80 ha,, e evidentuar në Qertifikatën e Pronës nr. 1742 si PSH e ish Sekretariatit të Mbrojtjes Popullore nga Gjilani, e të cilën e shfrytëzon Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës, në tërsi sipas paraqitjes grafike të dhënë nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit, e cila është pjesë përbërse e këtij Vendimi.

2.

Propozim Zgjidhja Urbanistike nga pika I. e këtij vendimi, nënkupton: caktimin e kushteve të lokacionit për ndërtimin e objektit nga pika 1. e këtij Vendimi.

3.

Obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit kushtet e lokacionit nga propozim zgjidhja Urbanistike tat ë Inkorporojë në Planin Rregullues Urban: Kampi Montith” I cili është në proces të hartimit.

4.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e KK-ës Gjilan, si dhe Drejtoria për Gjoedezi, Kadastrër dhe Pronë e KK-ës Gjilan

5.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

6.

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

Nr. 16-38238 — K r y e s u e s i,
Gjilan, më: 06.04.2012. — Izmi Zeka